

# Bibël për fëmijët paraqet

## Jezusi Qetëson Detin me Stuhi



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: Janie Forest

Përkthyer nga: Arianit & Valbona Iljazi

Adaptuar nga: Ruth Klassen

Tregimi 48 nga 60

[www.M1914.org](http://www.M1914.org)

*Bible for Children, PO Box 3, Winnipeg, MB R3C 2G1 Canada*

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.

Shqip

Albanian



Jezusi dhe dishepujt e Tij ishin në një barkë, kur filloi një stuhi e madhe. Ajo e trazoi keqazi detin e Galileë. Kjo lloj stuhie, mund ti bënte copash anijet dhe ti mbyste fare.

1

Stuhia i tmerroi dishepujt. Dallgët e mbuluan varkën, duke e mbushur me ujë. Por, Jezusi ishte në gjumë të thellë, duke fjetur në mes të stuhisë.



2

Dishepujt e zgjuan Jezusin duke bërtitur,  
"Mësues, Mësues, ne po mbytemi!"




3

"Përse jeni të frikësuar, o ju besimpakët?", i pyeti Jezusi dishepujt. Pastaj Jezusi urdhëroi erën të pushojë së fryri ... Dhe Jezusi urdhëroi edhe dallgët e furishme të uleshin dhe qetësoheshin ...



4

DHE ERA PUSHOI ... EDHE DETI U QETËSUA.  
Dishepujt u mrekulluan dhe thanë: "Kush është ky,  
që madje edhe era edhe deti, i binden Atij"?!"



5

Ca kohë më vonë, Jezusi,  
kishte një tjetër ditë shumë  
të zënë me punë. Mbi 5000  
njerëz, e kshin ndjekur Atë  
në një vend të  
shkretë.




6

Nëpërmjet fuqisë së Perëndisë,  
Jezusi, e ushqeu turmën duke  
përdorur vetëm drekën e një çuni  
të vogël. Tani erdhi mbrëmja.  
Jezusi e dërgoi  
gjithsecilin për  
në shtëpi.



7

Madje, edhe dishepujt duhet të largoheshin.  
Jezusi bëri që ata të hipin në varkë dhe të shkonin  
përpara Tij, në anën tjetër të Detit të Galileesë.



8




Pasi e dërgoi gjithkënd tutje, Jezusi shkoi lart në një mal për tu lutur, pa pasur njeri me vete. Kur po errej, Ai qëndronte atje, i vetëm.

9



Atje në mes të liqenit, dishepujt i zuri një stuhie e madhe. Stuhia i ndaloi ata të dilnin në breg edhe pse i dhanë shumë fort rremave për orë të tëra.

10




Dishepujt nuk e dinin, por ata i priste një surprizë e madhe.

11



Diku ndërmjet orës tre dhe gjashtë të mëngjesit, në mes të detit të trazuar, dishepujt panë diçka që i mbushi me frikë. "Është një fantazëm" bërtitën ata.

12



Por, në të vërtetë ishte Jezusi, Zoti dhe Mësuesi i tyre, që po vinte drejt tyre, **DUKE ECUR MBI UJË.**

13



"Merrni zemër", u thirri Jezusi atyre. "Jam Unë; mos kini frikë". Pjetri u përgjigj, "Zot, nëse je Ti, më urdhëro të vi tek Ty, përmbi ujë".

14

Kështu që Jezusi i tha: "Eja". Me trimëri, Pjetri doli prej barke në ujë dhe filloi të ecë drejt Jezusit.



15

Por, kur ndjeu erën që turfullonte, Pjetri pati frikë, dhe filloi të zhytet; ai bërtiti: "Zot më shpëto".



16

Menjëherë, Jezusi zgjati dorën dhe e kapi Pjetrin duke i thënë, "O ti besimpak, përse dyshove?" Dhe sapo Pjetri me Zotin Jezus u ngjitën në varkë, era pushoi.



17

Pas kësaj, ata që ishin në varkë, erdhën dhe e adhuruan Jezusin, duke thënë: "Me të vërtetë Ti je Biri i Perëndisë".



18

Jezusi Qetëson Detin me Stuhi

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Mateut 8, Mateut 14, Markut 4,  
Llukës 8

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Denimi për mekatin është vdekja.

Perëndia na don neve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij, Jezusin, që të vdes në Kryq dhe të paguaj dënimin tonë. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lartë në Qiell.

Nëse ti do që të pendohesh, thuaja këtë Perëndisë: Perëndi i dashur, unë besoj në Jezusin që vdiq për mua dhe jeton. Të lutem eja në jetën time dhe m'i fal mëkatet, në mënyrë që të kem jetën e re. Dhe që të jem me Ty përgjithmon. Më ndihmo që të jetoj për Ty si fëmija i Yt. Amen. Gjoni 3:16

**Lexo Biblën dhe fol me Perëndinë çdo ditë!**

